



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.32.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
JUNIKUT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Junikut në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Ilir Abazi, Udhëheqës i Ekipit të Auditimit, dhe Arben Hundozi - Anëtar i Ekipit, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Mujë Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	20
5 Qeverisja e mirë.....	21
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	24
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	27
Shtojca III: Letër konfirmimi	33

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Junikut për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 24/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Junikut.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson menaxhmentin dhe stafin e komunës, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pronat komunale nuk janë regjistruar në modulën e pasurisë në SIMFK, ndërsa për pasurinë jokapitale nuk ka regjistër të plotë dhe të saktë.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Junikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Junikut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- 275 prona komunale nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël të SIMFK-së;
- Objekti arsimor i Junikut në vlerë neto 185,009€, edhe me tutje mbetet gabimisht i regjistruar në regjistrin kontabël të thesarit në kuadër të Komunës së Deçanit; dhe
- Programi e-pasuria nuk është përdorur mjaftueshëm, dhe si rezultat nuk ekziston një regjistër i plotë dhe i saktë për pasurinë jokapitale dhe materialin shpenzues. Kjo reflekton pasaktësi në regjistrin e pasurisë dhe shpалosje të pasaktë në PVF-të e vitit 2017.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Junikut është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime). Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpалosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna e Junikut kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Pyetësin e vet-vlerësimit të komponenteve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
- Planin vjetor të prokurimit dhe raportin vjetor të kontratave të nënshkruara publike; dhe
- Harmonizimet tremujore të shpenzimeve dhe të hyrave me Thesar.

PVF-të janë përgatitur në pajtueshmëri me formatin për raportim, si dhe janë nënshkruar dhe dorëzuar brenda afatit ligjor në MF.

Komuna e Junikut ka korrigjuar PFV-të duke përmirësuar raportimin e tyre, mirëpo edhe me tutje shpalosjet për pasurinë kapitale, pasurinë jokatitale dhe materialit shpenzues nuk janë të sakta (ref. Theksimi i çështjes të opinionit të auditimit).

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm kemi identifikuar se Komuna nuk ka dërguar në Ministrinë e Financave raporte të detajuara tremujore për progresin fizik në zbatimin e projekteve kapitale.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, si dhe të marrë veprime specifike për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe për ta konfirmuar menaxhimin, evidentimin dhe raportimin e saktë të pasurisë.

Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme. Gjithashtu kryetari duhet të sigurojë se janë përmbushur të gjitha kërkesat tjera për raportim konform kërkesave rregullative.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Edhe pse Komuna e Junikut ka bërë një numër përmirësimesh në qeverisje, ende mbetin një numër fushash ku nevojiten zhvillime të mëtutjeshme. Disa nga çështjet e ngritura nga auditimi i vitit të kaluar nuk janë shqyrtuar sa duhet. Regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë nuk është trajtuar sa duhet nga menaxhmenti.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive - por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar mangësitë e identifikuara. Përmirësime kërkohej kryesisht në planifikimet e blerjeve përmes prokurimit publik, si dhe në menaxhimin e obligimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,533,899	1,814,384	1,754,304	1,584,964	1,785,539
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,391,912	1,542,163	1,534,867	1,179,419	1,241,339
Të hyrat e bartura ²	-	17,699	17,697	13,442	20,850
Të hyrat vetjake ³	141,987	141,987	89,483	69,306	64,122
Donacionet e brendshme	-	20,917	20,900	4,082	-
Donacionet e jashtme	-	91,618	91,357	318,715	459,228

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 280,484€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak, si dhe ndryshimeve të aplikuara pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2017, Komuna e Junikut ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 1,754.304€, me një rritje prej 3% krahasuar me vitin 2016. Realizimi i buxhetit është shfrytëzuar në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,533,899	1,814,384	1,754,304	1,584,965	1,785,539
Pagat dhe Mëditjet	1,000,466	1,056,758	1,054,758	1,005,752	1,091,463
Mallrat dhe Shërbimet	130,012	189,563	184,416	211,927	291,150
Shërbimet komunale	30,000	30,000	29,476	29,904	29,232
Subvencionet dhe Transferet	5,755	6,050	6,050	5,460	7,000
Investimet Kapitale	367,666	532,013	479,604	331,922	366,694

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Paga dhe mëditje – buxheti final është rritur për 56,292€. Rritja është ndikuar nga donacionet e jashtme në vlerë 36,042€ dhe në pajtim me vendimin e qeverisë për 20,251€;
- Mallra dhe shërbime – buxheti final është rritur për 59,551€. Fillimisht kjo rritje është ndikuar nga të hyrat vetanake të bartura nga viti paraprak në vlerë 3,676€ dhe nga donacionet e jashtme në vlerë 25,875€. Me ndryshimet e aplikuara pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë kjo kategori është rritur edhe për 30,000€;
- Shërbimet Komunale – nuk ka pasur ndryshim buxhetor për këtë kategori;
- Subvencionet dhe Transferet – buxheti final është rritur nga të hyrat e bartura prej vitit paraprak në vlerë 295€; dhe
- Investimet Kapitale – buxheti final është rritur për 164,346€. Kjo rritje është ndikuar nga të hyrat vetanake të bartura nga viti paraprak në vlerë 13,728€ dhe nga donacionet në vlerë 50,619€. Me ndryshimet e aplikuara pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë kjo kategori ekonomike është rritur edhe për 100,000€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Junikut ishin 122,377€, apo 86% e planit. Në raport me vitin paraprak, niveli i realizimit të të hyrave është rritur për 46%. Në të hyrat e realizuara dominojnë të hyrat nga taksat komunale për leje ndërtimore në vlerë 42,293€ dhe të hyrat nga tatimi në pronë 39,677€. Komuna mbledh edhe lloje tjera të të hyrave, si të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të inspektimit dhe taksa tjera administrative.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	141,987	141,987	122,377 ⁴	83,989	77,573

Çështja 2 - Mangësi në realizim dhe regjistrim të të hyrave

E gjetura Plani i inkasimit nga të hyrat për licencat dhe lejet për ushtrimin e veprimtarisë afariste ishte realizuar vetëm 24%. Madje të hyrat e realizuara në këtë kod ekonomik të të hyrave janë evidentuar gabimisht në SIMFK si taksa tjera administrative.

Gjithashtu, në dy raste, të hyrat në vlerë 1,950€ përveç që ishin regjistruar me dy javë vonesë në SIMFK, ato as nuk ishin klasifikuar në kodet përkatëse ekonomike.

Rreziku Ngecjet në inkasimin e të hyrave ndikon negativisht si në aspektin buxhetor të komunës ashtu edhe në mos realizimin e programit vjetor. Regjistrimi me vonesë dhe keq-klasifikimi i të hyrave e vështirësojnë harmonizimin e të dhënave dhe raportimin financiar.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të sigurojë se performanca e inkasimit monitorohet në mënyrë sistematike nga drejtoritë përkatëse dhe zyra e financave, dhe që ky rishikim adreson me kohë barrierat që vështirësojnë inkasimin e të hyrave sipas planit. Gjithashtu, të sigurohet se të hyrat klasifikohen drejtë dhe regjistrohen me kohë në SIMFK.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike dhe MF. Në fund të vitit 2017, Komuna e Junikut kishte 201 të punësuar, përfshirë edhe 39 anëtarët e Kuvendit Komunal. Për paga dhe mëditje është shpenzuar

⁴ Në këtë vlerë nuk janë përfshirë edhe të hyrat indirekte nga gjobat në trafik dhe dënimet gjyqësore në vlerë totale 5,633€.

pothuajse i tërë buxheti i kësaj kategorie apo 1,054,758€. Pjesëmarrja e shpenzimeve të pagave dhe mëditjeve në shpenzimet totale të komunës është 60%.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Auditimi ynë ka përfshirë dosjet e personelit, procedurat e rekrutimit, vlerësimet vjetore të performancës, pensionimet, si dhe pushimet pa pagesë dhe të lehonisë. Personeli administrativ me status të shërbyesve civil menaxhohet nga zyra e personelit në Komunë, ndërsa personeli edukativo-arsimor dhe personeli shëndetësor menaxhohen nga drejtorit përkatëse, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Çështja 3 - Parregullsi në menaxhimin e personelit

E gjetura

Auditimi në menaxhimin e personelit ka identifikuar se:

- Për pozitën e punës *Mësimdhënës/e programi fillor*, procesi i rekrutimit ishte zhvilluar edhe pse nuk ishte plotësuar kushti që për pozitën e shpallur të jenë së paku tre kandidatë. Gjithashtu, ndonëse ishte kërkuar me konkurs, kandidati nuk kishte ofruar vërtetimin nga gjykata që dëshmon se aplikuesi/ja nuk është në procedurë të hetimeve apo i dënuar me vepër penale;
- Për pozitën *Infermiere e mjekësisë familjare*, nuk ishin zhvilluar procedura të rregullta të rekrutimit. Për zëvendësimin e vendit të lirë, me vendim ishte angazhuar një punonjëse e cila edhe më herët kohë pas kohe ishte angazhuar përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta; dhe
- Kontratat e punës së personelit shëndetësor ishin hartuar bazuar në ligjin e shërbyesve civil. Çështjet e punësimit dhe kontratave për këtë kategori të punonjësve trajtohen përmes ligjit të punës. Pas rekomandimeve tona, menaxhmenti ka ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe nga fillimi i vitit 2018 kontratat e punonjësve shëndetësor janë përpiluar në bazë të ligjit të punës.

Rreziku

Shmangia dhe mos zbatimi i duhur i kërkesave dhe procedurave të rekrutimit, përveç që është në kundërshtim me rregullat dhe procedurat ligjore, rrit rrezikun të rezultojë me angazhimin e personave jo të duhur si dhe nuk siguron nëse është punësuar personel adekuat.

Rekomandimi 3

Kryetari duhet të sigurojë se aktivitetet e rekrutimit zhvillohen në pajtim me procedurat dhe rregulloret relevante të cilat sigurojnë trajtim të barabartë për të gjithë konkurrentët potencial.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra e shërbime si dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 219,563€. Prej tyre ishin shpenzuar 213,892€, apo 97% e buxhetit të këtyre dy kategorive. Kryesisht ato kanë të bëjnë me shpenzimet e shërbimeve komunale dhe me aktivitetet operative që ndërlidhen me shërbime tjera kontraktuese, furnizim për zyre dhe pajisje, derivate, mirëmbajta etj.

Çështja 4 - Mangësi në menaxhimin e marrëveshjeve për shërbime të veçanta

- E gjetura** Përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta ishin angazhuar nëntë punonjës. Nuk ishte zhvilluar ndonjë procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit me rastin e përzgjedhjes së tyre. Kontratat e pesë punonjësve kishin tejkaluar afatin kohor ligjor prej gjashtë muajve. Punonjësit ishin paguar në pagën bruto, duke mos u ndalur në burim tatimi dhe kontributet pensionale. Pas rekomandimeve tona, në fund të vitit, zyra e financave ka filluar ndaljen në burim të tatimit dhe kontributeve pensionale.
- Rreziku** Anashkalimi i procedurave të thjeshtësuar të rekrutimit me rastin e lidhjes së kontratave për shërbime të veçanta, rrit rrezikun të rezultojë me angazhimin e personave jo të duhur për kryerjen e shërbimeve të kërkuara. Gjithashtu neglizhenca e komunës për mbajtjen e tatimit në burim, rrit rrezikun që komuna të jetë subjekt i ndëshkimeve nga autoritetet tatimore.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurojë se marrëveshjet për shërbime të veçanta lidhen pas zhvillimit të procedurave të thjeshtësuar të rekrutimit dhe vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike, si dhe ato të realizohen brenda afatit kohor të përcaktuar me kornizën ligjore.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Komuna e Junikut ka shpenzuar tërë buxhetin final për subvencione dhe transfere në vlerë 6,050€. Subvencionet janë dhënë për përfitues individual dhe për entitete jo publike.

Çështja 5 - Mungesa e rregullores për subvencione

- E gjetura** Komuna e Junikut nuk ka rregullore të aprovuar për ndarjen e subvencioneve. Një draft rregullorë ishte në proces të hartimit, megjithëse akoma nuk ishte bërë aprovimi i saj nga ana e komunës.
- Rreziku** Mungesa e rregullores krijon paqartësi rreth projekteve të subvencionuara, dhe nëse ndarja e subvencioneve është në përputhje me planet dhe objektivat e përcaktuara.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të sigurojë se rregullorja për subvencione finalizohet dhe aprovohet brenda një periudhe të shkurtër pas pranimit të këtij raporti.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 532,012€, ndërsa janë shpenzuar 479,604 ose 90% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me financimin e projekteve kapitale në infrastrukturën rrugore, objektet arsimore dhe mirëmbajtjen investive, hartimin e projekteve, etj.

Çështja 6 - Mangësi në blerjet përmes prokurimit publik

- E gjetura** Në aktivitetin e prokurimit *Asfaltimi i rrugëve lokale në Junik*, në vlerë 437,390€, një nga kriteret ishte edhe kërkesa për kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës. Ofertuesit duhej të kishin mjete të gatshme në llogari bankare së paku 20,000€ ose qasje të pakushtëzuar në kredi. Në dëshminë bankare të ofruar nga operatori ekonomik fitues, nuk tregohet nëse ka mjete të gatshme në llogari dhe nuk garantohej për qasje të pakufizuar në kredi.
- Rreziku** Mos zbatimi i kriterit të kërkuar, rrit rrezikun që kontraktuesi mund të mos ketë kapacitetin e mjaftueshëm financiar në realizimin e kontratës sipas kushteve kontraktuale.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të sigurojë se kontratat publike nënshkruhen vetëm me operatorët që përmbushin në tërësi kriteret e kërkuara me dosje të tenderit.

Çështja 7 – Ndarje jo e drejtë e detyrave dhe përgjegjësi

E gjetura	Te kontrata <u>Asfaltimi i rrugëve lokale në Junik</u> , menaxher i kontratës ishte caktuar kryesuesi i komisionit për vlerësimin e ofertave për këtë projekt. Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik, përcakton se anëtarët e komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohen si menaxher të projektit.
Rreziku	Delegimi jo i duhur i detyrave dhe përgjegjësi mund të ndikojë negativisht në menaxhimin financiar dhe operativ të projektit.
Rekomandimi 7	Kryetari duhet të siguroj ndarja e detyrave dhe përgjegjësi bëhet në përputhje me kërkesat dhe rregulloret për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta në fushën e prokurimit që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale.

Çështja 8 – Planifikimi dhe blerjet përmes procedurave të prokurimit

E gjetura	Zbatimi i prituri i udhëzimeve të prokurimit nuk është arritur për shkak të mungesës së mbikëqyrjes efektive menaxheriale. Kjo ka rezultuar në: <ul style="list-style-type: none"> • Planifikime jo të sakta nga njësitë kërkuese për blerjet e planifikuara për t'u realizuar me procedura të prokurimit publik; • Për tri kontrata siguria e ekzekutimit nuk mbulonte edhe periudhën 30 ditore nga përfundimi i saj; dhe • Në 10 raste zotimi i mjeteve buxhetore dhe urdhërblerja ishin bërë pas pranimit të faturës, apo pas përfundimit të punimeve/furnizimeve;
Rreziku	Dobësitë në planifikim dhe realizim të aktiviteteve të prokurimit mund të ndikojnë negativisht në aspektin buxhetor dhe në zbatim të kontratave.
Rekomandimi 8	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim për të gjeturat e auditimit ku proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive dhe nuk është aplikuar mbikëqyrja e përshtatshme. Në këtë aspekt, të bëhen analiza të detajuara lidhur me planifikimin dhe realizimin e kontratave.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas PVF-ve, vlera neto e pasurisë kapitale në fund të vitit është 2,094,057€, ndërsa e pasurisë jokapitale 102,607€. Komuna e Junikut ka krijuar komision punues dhe ka bërë inventarizimin apo numërimin fizik të pasurisë në fund të vitit 2017. Një komision tjetër punues për vlerësimin e pasurisë gjithashtu ishte krijuar. Komisioni ende ishte në proces të punës, megjithatë ende janë evidentuar mangësi në regjistrin kontabël të pasurive, çështje kjo të cilën e kemi trajtuar tek Kapitulli i Opinionit të Auditimit – Theksimi i çështjes. Përveç kësaj, janë hasur edhe mangësi tjera të prezantuara në vijim.

Çështja 9 – Mungesë e kontrolleve në menaxhimin e automjeteve zyrtare

- E gjetura** Ekzistojnë dobësi në menaxhimin e automjeteve zyrtare. Nuk ka evidencë të plotë e të saktë rreth shfrytëzimit të automjeteve zyrtare. Mungojnë informatat rreth kërkesave dhe autorizimeve për përdorimin e automjeteve dhe kilometrave të kaluara.
- Rreziku** Mungesa e kontrolleve dhe menaxhimit rrit rrezikun që automjetet të shfrytëzohen edhe për qëllime tjera jo zyrtare.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të sigurojë se automjetet zyrtare shfrytëzohen në pajtim me rregullat dhe kërkesat ligjore. Për secilin automjet zyrtar të shfrytëzuar duhet të mbahet evidencë e plotë dhe e saktë lidhur me kilometrat e kaluara si dhe të dhëna tjera të nevojshme.

3.10 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme (LI/A) kanë të bëjnë me tatimin në pronë dhe të hyrat nga taksat në biznes.

Çështja 10 – Menaxhimi jo i mirë i llogarive të arkëtueshme

- E gjetura** Llogaritë e arkëtueshme nuk janë menaxhuar si duhet. Menaxhmenti nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme në inkasimin me kohë të të arkëtueshmeve. Siç edhe është prezantuar në PVF, vlera e përgjithshme e tyre arrin në 191,942€, ku 74% e tyre i takon tatimit në pronë.
- Saldoja e llogarive të arkëtueshme për taksat në afarizëm në fund të vitit 2017 ishte 50,079€. Te arkëtueshmet kishin mbetur të pa inkasuara nga viti 2009 e tutje. Në dy raste të testuara nga taksat për ushtrimin e aktiviteteve biznesore, nuk ishte bërë asnjë pagesë gjatë vitit 2017. Inkasimet nga ky lloj i të hyrave kishin normën më të ulët të realizimit.
- Rreziku** Vonesat në inkasimin e të hyrave reduktojnë fondet e mbledhura për buxhetin e Komunës dhe vështirësojnë përmbushjen e programit vjetor.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore, për të siguruar inkasimin me kohë të llogarive të arkëtueshme.

3.11 Obligimet e papaguara

Sipas PFV-ve, obligimet e papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 51,580€, ku prej tyre, 27,582€ i takojnë investimeve kapitale, 12,488€ për mallra e shërbime, dhe 11,513€ shërbimeve komunale. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Përveç detyrimeve financiare, Komuna e Junikut përballet edhe me detyrime kontingjente, dhe vlera e tyre pritet të jetë rreth 43,000€.

Çështja 11 - Hyrje në obligime pa mjete buxhetore

E gjetura Komuna nuk ka menaxhuar si duhet obligimet ndaj furnitorëve. Obligimet e papaguara datojnë që nga viti 2014 dhe vitet pasuese. Ato nuk janë paguar për shkak të hyrjes në obligime pa u siguruar mjetet e mjaftueshme buxhetore. Gjithashtu janë evidentuar edhe vonesa në pagesën e obligimeve ndaj furnitorëve.

Rreziku Hyrja në obligime pa u siguruar paraprakisht mjetet financiare si dhe mos pagesa me kohë e obligimeve mund të shkaktojë kosto shtesë dhe dëmtim të buxhetit nga ngritja e padive gjyqësore prej furnitorëve.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të sigurojë kontrollë shtesë në menaxhimin e obligimeve ndaj kontraktuesve. Hyrja në obligime të bëhet vetëm nëse paraprakisht janë zotuar mjetet e mjaftueshme financiare. Obligimet të paguhen brenda afatit kohor prej 30 ditëve nga data e pranimin të faturave.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të Komunës së Junikut ka rezultuar në 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, katër rekomandime janë zbatuar; katër të tjera ishin në proces të zbatimit dhe gjashtë nuk janë adresuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 16 rekomandime, dhe në vitin 2017, gjashtë nga to ishin zbatuar, pesë rekomandime ishin në zbatim e sipër dhe pesë të tjera nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 12 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga vitet paraprake

E gjetura Komuna e Junikut ka zbatuar kërkesat për të hartuar një plan veprimi brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit për vitin 2016 të ZKA-së, por kjo nuk është mbështetur me një proces konfirmues ku zbatimi i rekomandimeve monitorohet formalisht. Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim pritet të identifikohen dhe adresohen. Një qasje e tillë është e nevojshme për të menaxhuar përmirësim të vazhdueshëm në tërë organizatën.

Përderisa vetëm pjesërisht janë zbatuar disa nga rekomandimet e vitit 2016 dhe ato të viteve të mëhershme, mangësitë në sistemet domethënëse mbesin të pa trajtuara sa duhet. Ne nuk kemi vërejtur se menaxhmenti aplikon masa përgjegjësie për mos zbatimin e rekomandimeve.

Rreziku Mos zbatimi i rekomandimeve të dhëna rrit rrezikun që përmirësimet e kërkuara të proceseve operationale dhe të tjera mund të mos zbatohen duke rezultuar në mos efikasitet të vazhdueshëm dhe humbje financiare.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të siguroj që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimit e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston ende një numër i dobësive të qeverisjes brenda Komunës së Junikut veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi cilësor të auditimit të brendshëm, nuk janë të vendosura sa duhet. Komiteti i auditimit nuk është themeluar, ndërsa rekomandimet e auditimit të brendshëm nuk janë adresuar në nivelin e duhur.

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës por edhe planet vjetore, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj. Komuna e Junikut ka hartuar planin zhvillimor komunal, planin rregullues urban, rregulloret e brendshme, planet vjetore të punës sipas drejtorive dhe raportin vjetor të punës.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Çështja 13 – Mos zbatim i duhur i rekomandimeve dhe mungesa e Komitetit të Auditimit

E gjetura Menaxhmenti nuk i ka trajtuar sa duhet rekomandimet e auditorit të brendshëm. Nga 38 rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit të brendshëm, NjAB ka vlerësuar se vetëm 15 prej tyre janë zbatuar, 13 në proces të zbatimit dhe 10 nuk ishin zbatuar. Ndërsa për një raport të auditimit nuk ishte përgatitur plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve. Komuna nuk ka të themeluar as Komitet të Auditimit.

Këto rezultate pasqyrojnë mungesën e vëmendjes së menaxhmentit në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit të auditimit të brendshëm ose për të kërkuar siguri për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme.

Rreziku Mangësitë e identifikuara zvogëlojnë sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare. Kjo mund të rezultojë me dobësi tjera të paidentifikuara, mos reagim me kohë ndaj sfidave potenciale dhe vazhdim të praktikave joefektive që mund të përfundojnë me vlerë të ulët për para dhe/apo humbje potenciale financiare për komunën.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e plotë të rekomandimeve të auditimit të brendshëm. Planet e veprimit në zbatimin e rekomandimeve të monitorohet vazhdimisht nga menaxhmenti. Gjithashtu të shqyrtohen mundësitë e krijimit të Komitetit të Auditimit, apo në bashkëpunim me ndonjë komunë tjetër të angazhojë komitetin e auditimit me komunën bashkëpunuese.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën. Menaxhmenti organizon takime me zyrtarët udhëheqës, dhe se ka vendosur një proces formal të raportimit të brendshëm nga drejtorit komunale.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara në disa raste nuk ishin edhe aq efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 14 - Procese jo formale në menaxhimin e rrezikut

- E gjetura** Komuna nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Ende nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, nuk ka strategji për menaxhimin e rrezikut, dhe nuk përgatitet ndonjë raport për menaxhimin e tyre. Kjo ka ndodhur si mungesë e llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë lidhur me procesin e menaxhimit të rrezikut si dhe mungesës së njohurive brenda drejtorive për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes për këtë proces.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv dhe gjithëpërfshirës të rrezikut do të dobësoj cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve nëse çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë, nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike
- Rekomandimi 14** Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut nëpër sektorët përkatës të administratës dhe të sigurojë raportim tremujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për kualifikimin e opinionit të auditimit dhe paragrafin e theksimit të çështjes. Veprimi duhet ndërmarrë për të adresuar dobësitë e rëndësishme në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të zbutur dobësitë e shpalosura në paragrafin e bazës për opinion të kualifikuar.		Komuna ka ndërmarrë masa përmirësimi. Është bërë inventarizimi i pasurisë dhe ka filluar vlerësimi i saj.	
	Kryetari duhet të marrë masat e duhura për të siguruar pajtueshmëri rregullative të plotë të procesit të përgatitjes së pasqyrave vjetore financiare (PVF). Deklarata e bërë nga Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhet vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës të menaxhmenti.		PVF janë përgatitur drejtë me përjashtim të shpalosjes së pasurisë.	
	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Komuna i dorëzon raportet mujore që lidhen me detyrimet e papaguara, dhe dorëzon pasqyrat financiare në gjuhën Serbe, siç kërkohet me rregulloren raportuese.	Po		
2.3. Rekomandimet e vitit paraparak	Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit, zbatohet, rishikohet dhe i njëjti përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga AP, me stafin përgjegjës të emëruar për monitorim rigoroz të këtij procesi.		Menaxhmenti kishte hartuar një plan veprimi, mirëpo niveli i zbatimit të rekomandimeve është i ulët.	

2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit nga MF	Kryetari duhet të sigurojë që lista kontrolluese e vetë-vlerësimit është plotësuar me objektivitet dhe është dokumentuar për të identifikuar dobësitë dhe për ti zvogluar ato në mënyrë të përshtatshme, siç kërkohet nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës.	Po		
2.5.2 Menaxhimi i Riskut	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që procedurat dhe sistemet e menaxhimit të riskut janë krijuar dhe janë funksionale. Për më tepër, përgjegjësia për menaxhimin e riskut është deleguar direkt në një drejtori përkatëse që të sigurojë raportimin mujor mbi zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe të siguroj se risqet janë duke u menaxhuar.			Nuk janë marrë masa.
2.5.3 Raportimi Menaxherial	Kryetari i Komunës duhet të rishikojë masat ekzistuese të qeverisjes së përgjithshme dhe cilësinë e raportimit të brendshëm të Komunës. Kërkesat pazbatuara duhet të adresohen deri në fund të vitit 2016. Cilësia e raportimit dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të shqyrtohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar arritjen e objektivave të Komunës.	Po		
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që komiteti i auditimit është emëruar dhe kryen detyrat e veta të kërkuara nga ligji. Kryetari duhet të sigurojë që aktiviteti i ardhshëm i AB të udhëhiqet në drejtim të zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit të bazuar në risk. Për më tepër, në mënyrë që përfitimet të jenë të dukshme, Kryetari duhet të marrë masa për zbatimin e të gjeturave të AB-së brenda Komunës.			Nuk janë marrë masa.

3.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari i Komunës duhet në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme të monitorojë performancën buxhetore, të identifikojë dhe adresojë pengesat për të planifikuar nivelet e realizimit të buxhetit. Kryetari duhet të sigurojë që plani i zbatimit për të hyrat vetanake përbën një plan realist dhe përkon me aftësitë e Komunës për të mbledhur të hyrat.	Po		
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të identifikoj shkaqet rrënjësore të mangësive dhe të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar se kërkesat e ligjit te prokurimit janë zbatuar plotësisht.		Në proces të zbatimit. Edhe këtë vit janë identifikuar mangësi në fushën e prokurimit.	
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të siguroj që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat, që ato të jenë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret përkatëse.	Po		
3.5.3 Subvencione dhe Transfere	Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi subvencione dhe transfere në mënyrë rigoroze dhe në përputhje me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.	Po		
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë regjistrimin në kohë dhe të saktë të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës, në përputhje me kërkesat e rregullores 02/2013. Ai gjithashtu duhet të sigurojë që pasuritë kapitale të cilat regjistrohen përmbajnë informacion të plotë, duke përfshirë datën kur pasuria është vënë në përdorim, në mënyrë që llogaritja e zhvlerësimit të mund të kryhet me saktësi. Si dhe të përcaktojë statusin e pronësisë.			Nuk janë marrë masa.
	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Komuna mban informacion të saktë dhe të plotë në lidhje me pasuritë jo-kapitale dhe të siguroj se ato janë të prezantuara në pasqyrat financiare.			Nuk janë marrë masa.

3.7.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që llogaritë e arkëtueshme janë shpalosur në mënyrë efikase dhe të detajuar, dhe për to mbahen dokumente dhe informacione të mjaftueshme. Për më tepër, Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Komuna do të marrë veprime të mëtejshme për arkëtimin e të hyrave dhe se ekzistojnë kontrollet e nevojshme të cilat sigurojnë që balancat e vjetra të shpalosura do të arkëtohen nga palët respektive.		LL/A janë shpalosur drejtë, por inkasimi nuk është në nivelin e pritur.	
3.7.4 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të sigurojë që Komuna do të ndër marrë hapa të mëtutjeshëm dhe të zhvilloj plane veprimi për të bërë pagesat brenda periudhës së kërkuar.			Nuk janë marrë masa.
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet e Theksimit të Çështjes. Të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të bërë regjistrimin e të gjitha pasurive kapitale. Po ashtu, duhet të sigurojë që procesi i përgatitjes së PFV-ve plotësisht adreson dobësitë e identifikuar në PFV.			Nuk janë marrë masa.
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka ngecje, të propozohen masat adekuate.		Menaxhmenti kishte hartuar një plan veprimi, mirëpo niveli i zbatimit të rekomandimeve është i ulët.	

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentave të MFK-së	Kryetari duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve dhe sigurojë që i njëjti i është deleguar për menaxhim një personi përgjegjës, i cili në mënyrë sistematike do të koordinoj masat dhe veprimet e përcaktuara me këtë dokument, si dhe do të raportoj në baza të rregullta tek menaxhmenti i komunës.			Nuk janë marrë masa.
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Për të shtuar mbikëqyrjen e cilësisë së shërbimeve të auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të sigurojë themelimin e Komitetit të auditimit.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se me rastin e aplikimit të koeficientëve, kërkesat ligjore zbatohen me konsistencë për të shmangur mundësinë e zvogëlimit apo rritjes së pa drejtë të ngarkesave tatimore. Po ashtu, verifikimi i 1/3 të pronave për tatimin në pronë të bëhet në baza vjetore dhe në kuotat e përcaktuara me ligj.	Po		
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të siguroj që rekrutimi i stafit të bëhet sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.			Nuk janë marrë masa.
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të siguroj se mbajtja e tatimeve në burim për personat e angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta, bëhet në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.	Po		
3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të hartoj një rregullore për subvencione dhe të aprovohet në kuvend, e cila specifikon qartë kriteret dhe procedurat për subvencionim. Sugjerimet tona janë se shumë nga komunat i posedojnë këto rregullore, dhe të njëjtat mund të merren si model dhe të përshtaten për nevojat e komunës.		Komuna ka përgatitur draft rregulloren për Subvencione, por ende nuk është finalizuar.	

3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se me rastin e pagesave të situacioneve të ardhshme për projektet në vazhdim si dhe projektet e reja, të aplikohet libri ndërtimor dhe i njëjti të harmonizohet me situacionet për të verifikuar saktësinë e punëve të kryera dhe shumat e pagesave. Menaxherëve të projekteve tu qartësohet se aktivitetet e ardhshme duhet të jenë në pajtim me ligjin e ndërtimit (Ligji Nr. 04/L - 110) si dhe (UA 15/2013 i MMPH mbi kushtet për mbajtjen e ditarit dhe librit ndërtimor).	Po		
	Kryetari duhet të siguroj që klasifikimi i shpenzimeve bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate të përcaktuara me planin kontabël, në mënyrë që kjo të reflektoj prezantimin e drejtë të shpenzimeve në PFV.	Po		
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të siguroj se janë regjistruar të gjitha pasuritë në modul të E-pasurisë, siç kërkohet me rregulloren 02/2013 për menaxhim të pasurisë.			Nuk janë marrë masa.
	Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur kontrole për shfrytëzimin e automjeteve për të siguruar llogaridhënie adekuate nga secili përdorues i automjeteve dhe për të evituar përdorimin jo të rregullt të tyre.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të siguroj kontrole më efektive të këtyre llogarive, duke i verifikuar dhe vendosur shumat e sakta, dhe pastaj të ndërmerr veprimet që sigurojnë një inkasim sa më të lartë të këtyre shumave.		Ka evidencë për të arkëtueshmet, por inkasimi nuk është në nivelin e pritur.	
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha faturat e pranuar së pari protokolohehen në librin e faturave hyrëse, dhe më pas, paguhen në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloret financiare.		Faturat protokolohehen, por ka vonesa në pagesë.	

Shtojca III: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Junikut, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Agron Kuçi

Kryetar i Komunitetit,

Data: 14 Qershor 2018, Junik,

